



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 15 qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DOMA GROUP” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GLOBAL INTERPRISE GROUP” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

U shty vendimmarrja e Bordit lidhur me kërkesën e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

U miratua rishikimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.08.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 MW”.

U miratua heqja e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “KORKIS-2009” sh.p.k.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u trajtua informacioni mbi gjendjen e sektorit të energjisë elektrike për 4-mujorin e vitit 2026.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.